



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTER
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 28 datë 30.07.2024

PËR

“KRIJIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË BASHKINË GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 2, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për veteqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 13, pika 2, të Ligjit nr.152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr.45/2016, "Për vullnetarizimin", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Keshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- 1.Krijimin e Sherbimit Vullnetar për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Gjirokastr.
- 2.Sherbimi Vullnetar është pjesë e shërbimit të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe ka një numër prej 36(tridhjetë e gjashtë) vullnetarësh.
- 3.Sherbimi vullnetar i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ka si mision kryesor rritjen e angazhimit qytetar dhe dhënien e kontributit vullnetar për parandalimin dhe nderhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, si dhe menaxhimin e fatkeqesive të tjera dhe zvogelimin e pasojave të tyre në territorin Bashkisë Gjirokastr.
- 4.Të miratojë strukturën e shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr.1, bashkelidhur dhe pjesë perberese e këtij vendimi.
5. Sherbimi vullnetar drejtohet nga Komandanti i shërbimit vullnetar, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e këtij shërbimi.
- 6.Të miratojë uniformën dhe shenjat dalluese të vecanta të shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr. 2, bashkelidhur dhe pjesë perberese e këtij vendimi.
- 7.Të drejtat dhe detyrimet, kushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare përcaktohen në kontratën e vullnetarizimit dhe lidhet midis Bashkisë Gjirokastr dhe anëtarëve të shërbimit vullnetar.
- 8.Në zbatim të pikës 7, të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës me vullnetarët.
- 9.Një kopje të këtij vendimi ti njoftohet Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Drejtorisë së Burimeve Njerezore Arkives dhe Protokollit.

10. Ngarkohen Kryetari i Bashkise , Njesia e Burimeve Njerezore, Drejtoria per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin, , Drejtoria e Urbanistikes (Sektori i Emergjencave Civile) per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te pikes 6, te nenit 55, te Ligjit nr. 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore " te ndryshuar.

KRYETAR

Merita ISARAJ



Sekretar i Këshillit.
Etleva Y20